

Pikë së pari lidhur me sa ju citoni ne kerkesen tuaj “...ndaj Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, zbulohet se mungonin raportet e monitorimit në vite të ndryshme për kompaninë “Bankers Petroleum Albania...” sjellim ne vemendjen tuaj se AKBN ka kryer çdo monitorim te mundshem ndaj Kompanise BPAL duke respektuar cdo parashikim kontraktual. Nese do ti referohemi sakte raportit te auditit te KLSH, citohet se AKBN duhet ti kerkoje Kompanise BPAL te dorezoje prane AKBN-se dokumentacionin lidhur me kostot e realizuara per vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021. Rekomandim i cili eshte realizuar prej AKBN-se dhe jemi ne pritje te plotesimit te dokumentacionit nga ana e Kompanise BPAL.

Lidhur me pikën 1.a, sqarojmë se në përputhje me parashikimet e Licencë Marrëveshjes AKBN ka kryer auditimin per periudhat 2014-2019, për të cilat ka konkluduar dhe raportet paraprake të auditimit. Aktualisht AKBN është ne proces auditimi per vitin 2020-2021, proces i cili po kryhet prane zyrave te shoqerisë.

Lidhur me pikën 1.b, sqarojme se për vitin 2022 shoqeria BPAL ka dërguar pranë AKBN raportimet tremujore, te cilat do te auditohen brenda afateve qe percakton LM per audit. Në përputhje me Nenin 23 të MH “Konfidencialiteti” “...*i gjithë informacioni i kryer apo përfituar ose marrë sipas kësaj marrëveshje do të mbahet nga Palët konfidencial në mënyrë strikte....*”. Duke qene se keto raporte jane dokumentacion i cili eshte perfituar prej parashikimeve kontraktuale, AKBN nuk mund të vërë në dispozicionin tuaj këto dokumentacione.

Lidhur me pikën 2, ashtu sikurse kemi cituar me siper, te dhenat e kerkuara prej jush sic eshte “vlera e koeficientit “R” për totalin e 4 raporteve 3-mujore të hartuara për vitin 2022”, sqarojme se AKBN nuk mund të vërë në dispozicionin tuaj keto te dhena per sa kohe kjo eshte nje tregues i perfituar nga MH per vendburimin Patos-Marinëz.

Lidhur me pikën 3, sqarojme faktin se AKBN është ne proces auditimi prane kesaj kompanie per vitet 2020, 2021 dhe 2022. Sqarojme se e drejta e AKBN per te audituar keto kompani, e parashikuar ne nenet specifike te kryerjes se auditimit, perfundon 3 (tre) vite pasi ka mbaruar viti fiskal.Gjithashtu pavaresisht ketij fakti, duke ju referuar parashikimeve kontraktuale te cituar dhe me siper, AKBN eshte e detyruar te repsektoje nenin perkates te Marreveshjes Hidrokarbure lidhur me konfidencialitetin.

Lidhur me pikat 4 dhe 5, se pari sqarojme faktin se Palë ne Marrëveshjen Hidrokarbure janë Kompania Albpetrol sh.a., dhe Kompania Bankers Petroleum Albania Ltd. Kompania Albpetrol ne rolin e partnerit në këtë MH, ndjek nga afër çdo operacion hidrokarbur të realizuar nga Kontraktori BPAL. Ashtu sikurse edhe per dokumentacionet e kerkuara nga ana juaj lidhur me Programet Vjetore dhe Buxhetet për vitet 2022-2023, Ju bëjmë me dije se keto programe perpara

dergimit prane AKBN-se do duhet te diskutohen dhe miratohen ndermjet Paleve te MH. Gjithashtu, sqarojme se në zbatim të Nenit 23 të Marrëveshjes Hidrokarbure lidhur midis Albpetrol sh.a., dhe Bankers Petroleum Albania Ltd., “...*i gjithë informacioni i kryer apo përfituar ose marrë sipas kësaj marrëveshje do të mbahet nga Palët konfidencial në mënyrë strikte...*”. Në të tilla kushte, AKBN nuk mund të vërë në dispozicionin tuaj këto dokumentacione.

Lidhur me pikën 6, sqarojme faktin se AKBN është një institucion teknik, i cili në sektorin hidrokarbur është i fokusuar në ndjekjen e operacioneve hidrokarbure që kryejnë kompanitë të cilat disponojnë një Marrëveshje Hidrokarbure. AKBN, ka kryer monitorime periodike cdo vit, në të gjitha vendburimet apo blloqet të cilat janë nënkontraktuar me investitorë vendas apo të huaj të cilët kryejnë operacione hidrokarbure. Lidhur me monitorimet mjedisore, ashtu sikurse ju e dini, ka institucione te specializuara dhe te caktuara me ligj qe kryejne keto procedura me qellim konstatimin nese jane shkaktuar deme mjedisore dhe ne cdo rast aplikimin e sanksioneve perkatese sipas parashikimeve ligjore.